



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 15237/prot.
2

Data: 23.1, 2025

VENDIM

Nr. 18, Datë 23.1, 2025

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE,
"CHARLES TELFORD ERIKSON", GOLEM, KAVAJË.

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", si dhe raportit të monitorimit të posaçëm për Skollën e Mesme Profesionale, "Charles Telford Erikson", Golem, Kavajë, dërguar nga AKAFPK me shkresën nr. 363/11prot.. datë 02.12.2024.

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale "Charles Telford Erikson", Golem, Kavajë, ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 6569 datë 21.05.2024, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Akreditim me kusht" me afat vlefshmërie deri më 20.11.2024.

2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin nr. 47 datë 02.12.2024, të miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv "Akreditim i plotë" dhe heqja e kushteve të akreditimit sipas Vendimin nr. 6569 datë 21.05.2024, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për kualifikimet profesionale si më poshtë vijon:

- "Bujqësi", Niveli II në KSHK, Kodi H-II-22;
- "Agroturizëm", Niveli III në KSHK, Kodi H8-III-18;
- "Bujqësi", Niveli IV në KSHK, Kodi H-IV-20;
- "Ekonomi – Biznes", Niveli II në KSHK, L-II-21;

- e) "Llogari", Niveli IV në KSHK, L4-IV-19;
- f) "Veterinari", Niveli IV në KSHK, N-IV-21;

3. Afati përfundimtar "Akreditimit të plotë" është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18, të Urdhrit nr.128 datë 6.7.2021, "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", ofruesi publik i AFP-së Shkolla e mesme profesionale "Charles Telford Erikson", Golem, do t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisht të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

